



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE

-S.T.I.M.P
07.06.2022

Korçë, me 02.06.2022

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : Bashkise Maliq

Per: shtetasen : Eriselda Mehmeti, me adrese Lgj nr 1
Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil
nr. 22, dt. 13.01.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj
njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi deftesa e
komunikimit eshte kthyer me shenimin : " Nuk njihet ne
kete adrese " dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet
e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

KANCELARE
Lubiana KINOLLI

U afishua sot ne date -----
Bashkia Maliq

Nenpunesi _____
(emer, mbiemer, firme)

Ms. 73 Prof

REPublika e SHqipërisë
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. 21001-00949-41-2021 (320/1061) Akti
Datë regj. 10.06.2021

Nr. Vendimi 41-2022-58 (22)
Datë Vendimi 13.01.2022

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e përbërë prej:

GJYQTAR: ERVIN SULAJ

Asistuar me sekretare gjyqësore **Zamira Shkëmbi**, sot me datë 13.01.2022. mori në shqyrtim në seancë gjyqësore. çështjen civile me Nr. 320/1061 Akti. që i përket:

PADITËSE:

Eriselda Mehmeti, e bija e Hektor dhe Lumturi. e datëlindjes 22.04.1986. lindur në Fier dhe banuese në Korçë. në adresën lagjia Nr. 16. rruga “Viktor Eftimiu”. P. 81, H. 1. Ap. 5 Korçë. sipas regjistrimit në gjendje civile dhe vendqëndrim në Maliq. lagjia Nr. 1. me shtetësi shqiptare. identifikuar me letënjoftimin me nr. 037155051 dhe numër personal I65422121N, përfaqësuar vetë në gjykim.

I PADITUR:

Zamir Mehmeti, i biri i Thimaq dhe Fatmira. i datëlindjes 12.04.1981. lindur dhe banues në Korçë. në adresën lagjia Nr. 16. rruga “Viktor Eftimiu”. P. 81, H. 1. Ap. 5 Korçë. me shtetësi shqiptare. në mungesë. me shpallje.

OBJEKTI:

1. Zgjidhja e martesës mes paditëses dhe të paditurit;
2. Lënia e fëmijëve Elina Zamir Mehmeti dhe Marina Zamir Mehmeti mua paditëses për rritje dhe edukim.
3. Detyrimi i të paditurit të kontribuojë financiarisht për rritjen dhe edukimin e fëmijëve;
4. Ndryshimin e mbiemrit të paditëses nga ai martesor “Mehmeti”. në atë paramartesor “Metani”.

BAZA LIGJORE: Neni 132 e vijues i Kodit të Familjes:

Gjykata pasi dëgjoi paditësen. e cila kërkoi pranimin e padisë dhe në mungesë të të paditurit:

VËRENJ:

I. Rrethanat e çështjes.

Paditësja Elriselda Mehmeti dhe i paditurin Zamir Mehmeti kanë lidhur martesë më datë 29.09.2019, në Bashkia Korçë, fakt i cili provohet me certifikatën e martesës, datë lëshimi 24.05.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë, Bashkia Korçë.

Nga kjo martesë ka ardhur në jetë dy fëmijë, Marina Mehmeti e datëlindjes 06.07.2011 dhe Elina Mehmeti, e datëlindjes 07.12.2012, të cila është janë të mitura, fakt i cili provohet me certifikatën personale të fëmijës si dhe me certifikatën familjare të datës 24.05.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë, Bashkia Korçë.

Gjykata në respektim të detyrimit procedural të parashikuar në nenin 134 të Kodit të Familjes, realizoi seancën e pajtimit në të cilën u paraqit paditësja dhe nuk u paraqit i paditurit, njoftimi i të cilit u bë përmes shpalljes publike.

Nga parashtrimet e bëra në kërkesëpadi dhe shpjegimet e dhëna në seancë pajtimore dhe gjyqësore, paditësja parashtroi se me të paditurin ka lidhur martesë ligjore më 20.09.2019, fillimisht marrëdhëniet mes tyre kanë qenë të mira dhe i paditurin jetonte në Greqi, ku ajo shkonte shpesh atje duke lindur dhe vajza e parë. Më pas kanë filluar problemet dhe ajo rrinte tek prindërit e saj dhe shkonte e vinte në Greqi. Pasi lindi vajza e dytë, qëndroi një vit tek të prindërit e të paditurit dhe pasi ka mësuar se ky i fundit kishte krijuar një lidhje tjetër është detyruar për tu larguar nga tek prindërit e saj. Që nga viti 2013 nuk ka asnjë kontakt me të paditurin, i cili nuk ka parë as fëmijët.

Në këto rrethana, paditësja shprehet se kërkon zgjidhjen e martesës me të paditurin pasi martesa e ka humbur tërësisht kuptimin dhe qëllimin e saj. Gjithashtu nga paditësja kërkohet marrja e mbiemrit paramartesor "Metani" dhe që ndaj të paditurit të caktohet një detyrim ushqimor në masën që do të vlerësohet nga gjykata.

Nga të dhënat e sistemit "TIVS" të administruara me shkresën nr. 1486 I prot. datë 13.07.2021 të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Korçë, i paditurin ka hyrjen e fundit territorin e Republikës së Shqipërisë, më datë 14.07.2013, ora 11:17, nga Puka e Kalimit Kufitar Kap blicë dhe nuk ka dalje për këtë datë.

Gjykata në zbatim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe detyrimeve që barojnë prej Kodit të Familjes, përkatësisht nenit 6 dhe nenit 155 të Kodit të Familjes, caktoi eksperte Elsuida Vila për të vlerësuar gjendjen psiko-emocionale të prindërve dhe fëmijës, marrëdhëniet prind fëmijë, të ardhurat dhe kushtet ku jetojnë prindërit, si dhe dhënien e mendimit në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, të drejtën e takimit të prindërve në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës së mitur.

Në gjykimin e kësaj çështje, gjykata administroi provat si më poshtë:

- *Certifikatë martesë nga akti e bashkëshortëve, datë 24.05.2021, e vërtetuar elektronikisht;*
- *Certifikatë familjare e bashkëshortëve dhe fëmijëve, datë 24.05.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë, Bashkia Korçë;*
- *Certifikatë personale e paditëses Elriselda Mehmeti, e fëmijëve të mitur Marina Mehmeti dhe Elina Mehmeti, datë 24.05.2021, të vërtetuara elektronikisht;*
- *Vërtetim datë 15.12.2021 lëshuar nga shoqëria "Lorenso" sh.p.s;*
- *Shkresën nr. 1486 I prot. datë 13.07.2021 të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Korçë;*
- *Report Vlerësimi Psikologjik, datë 13.01.2022, për gatim nga eksperte psikologje Elsuida Vila.*

2. Vlerësimi i gjykatës.

Në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: "1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. 2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. 3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj".

Në nenin 12 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut parashikon se: "Që nga moshë e martesës, burri dhe gruaja kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte".

Në nenin 1 të K.Familjes parashikohet se: "Martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në bazë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit".

Në nenin 50 të K.Familjes, me titull "Detyrimi për besnikëri, ndihmë dhe bashkëpunim" parashikon se: "Me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime. Nga martesa lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës".

Në nenin 51 të K.Familjes, me titull "Mbiemri i bashkëshortit" parashikohet se: "Bashkëshortët, kur lidhin martesën, kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet".

Në nenin 55 të K.Familjes, me titull "Vendbanimi i bashkëshortëve" parashikohet se: "Bashkëshortët kanë detyrimin e jetesës së përbashkët. Vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët. Në rast mosmarrëveshjeje, secili nga bashkëshortët mund t'i drejtohet gjykatës, e cila, pasi dëgjon mendimet e të dy bashkëshortëve dhe, nëse është rasti, edhe mendimin e fëmijës që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, mundohet të arrijë një zgjidhje me mirëkuptim. Kur kjo nuk është e mundur, gjykata vendos zgjidhjen që e quan më të përshtatshme për kërkesat e familjes".

Në nenin 123 të K.Familjes parashikohet se: "Martesa mbaron me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort ose me zgjidhjen e martesës së tyre".

Në nenin 129 të K.Familjes, me titull "Zgjidhja e martesës për ndërprerje të jetesës së përbashkët", parashikohet se: "Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh.

Nëse është rasti, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës, sipas paragrafit të parë të këtij neni, duhet të përcaktojë në kërkesëpadinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër."

Në nenin 132 të K.Familjes, me titull "Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort", parashikohet se: "Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimit, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët".

Në nenin 133 të K.Familjes, parashikohet se: "Gjykata vendos për fajësinë, në zgjidhjen e martesës, vetëm kur kjo kërkohet prej njërit ose të dy bashkëshortëve."

Në nenin 143 të K.Familjes, me titull "Dërgimi i vendimit në zyrën e gjendjes civile", parashikohet se: "Pasi të ketë marrë formë të prerë, vendimi për zgjidhjen e martesës i dërgohet nga gjykata për regjistrim zyres së gjendjes civile përkatëse."

Në nenin 146 të K.Familjes, me titull "Përdorimi i mbiemrit", parashikohet se: Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës. Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës.

Në nenin 154 të K.Familjes, me titull "Pasojat e zgjidhjes së martesës për fëmijët", parashikohet se: "Zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë Kod."

Në nenin 155 të K.Familjes, parashikohet se:

Në nenin 156 të K.Familjes, parashikohet se: "Gjykata vendos për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive prindërore ose për t'i besuar fëmijën një të treti, mbi bazën e kërkesës së njëres prej palëve, pjesëtarëve të familjes ose prokurorit, në rast se ka shkaqe të rëndta që janë të lidhura me ushtrimin abuziv të përgjegjësive prindërore."

Në nenin 157 të K.Familjes, parashikohet se: "Gjyqtari, në këtë rast, merr në konsideratë: ai marrëveshjen e bërë ndërmjet ish-bashkëshortëve; bi mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij; bi mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkisë, pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën."

Në nenin 158 të K.Familjes, parashikohet se: "Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij."

E drejta e vizitës dhe e banimit sipas kushteve të përcaktuara nga gjykata, nuk mund t'i refuzohet në asnjë rast për arsye të rëndta që dëmtojnë interesat e fëmijës."

Në nenin 161 të K.Familjes, parashikohet se: "Në vendimin e zgjidhjes së martesës caktohet dhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën dhe për ish-bashkëshortin, nëse është rasti, sipas parashikimeve të kësaj "Detyrimi për ushqim" të këtij Kodi."

Në nenin 197 të K.Familjes, me titull "Detyrimi për ushqim ndërmjet prindërve dhe fëmijëve", parashikohet se: "Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar."

Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijet madhorë mbejnë shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç."

Në nenin 201 të K.Familjes, me titull "Kudijtë e detyrimit për ushqim" parashikohet se: "Detyrimi për ushqim mund të kërkojë vetëm nga ai që është nevojtar dhe nuk është në gjendje të sigurojë nevojat e domosdoshme të tij."

Detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e atij që kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Ai nuk duhet të kapërcëjë atë që është e nevojshme për jetën e personit që detyrohet për ushqim, duke pasur parasysh rrethanat e jetës së tij."

2.1. Në lidhje me kërkimin për zgjidhjen e martesës.

Gjykata vlerëson se, në kuadrin e të drejtave themelore të njeriut, një vend të posaçëm zë edhe e drejta për martesë.

Më konkretisht neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: *"Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohet me ligj"*.

Kodi ynë i Familjes nuk jep një përkufizim të drejtpërdrejtë lidhur me institutin juridik të martesës, por neni 1 i këtij kodi përcakton disa elementë nga të cilët mund të nxjerrim një përkufizim juridik mbi martesën. Gjykata vlerëson se në interpretim të nenit 1 dhe 50 të K.Familjes, të sipërcituar, ekzistenca e martesës si një marrëdhënie juridike dhe vazhdimësia e saj kërkon pëlqimin dhe vullnetin e lirë të palëve jo vetëm në momentin e lidhjes së saj, por edhe gjatë vazhdimësisë së saj. Në kushtet kur njëri prej bashkëshortëve vlerëson se martesa, si jetesë e përbashkët ligjore, e ka humbur qëllimin e saj dhe nuk mbështetet më në barazinë morale e juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, ligjvënësi i ka njohur mundësinë të zgjidhë martesën.

Legjislatori, duke dashur të mbrojë veçanërisht martesën për shkak të natyrës *sui generis* të saj, ka legjitimuar në Kodin e Familjes vetëm disa raste nëpërmjet të cilave mund t'i jepet fund një marrëdhënie të tillë, duke i parashikuar në mënyrë shteruese ato. Konkretisht, K.Familjes parashikon tri raste përmes së cilave bashkëshortët, mund të kërkojnë zgjidhjen e martesës midis tyre, të cilat janë:

a) zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok midis bashkëshortëve.

b) zgjidhja e martesës për ndërprerje të jetesës së përbashkët.

c) zgjidhja e martesës për shkaqe të parashikuara në nenin 132 të Kodit të Familjes.

Në rastin objekt gjykimi, paditësja është bazuar në parashikimet e nenit 132 të K.Familjes i cili parashikon të drejtën e secilit bashkëshort që të paraqesë kërkesëpadi për zgjidhjen e martesës në rastet që për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, është bërë e pamundur vazhdimi i jetesës së përbashkët dhe martesa e ka humbur qëllimin për njërin nga bashkëshortët apo të dy ata.

Në analizë të kësaj dispozite, në mënyrë që gjykata të japë vendim për zgjidhjen e martesës duhet të plotësohen në mënyrë kumulative tre kushte:

a) shkakun për të cilin kërkohet zgjidhja e martesës;

b) pamundësinë e jetës së përbashkët dhe humbjen e qëllimit të martesës për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët.

c) lidhja shkakësore ndërmjet shkakut për të cilin kërkohet zgjidhja e martesës dhe pamundësisë së jetës së përbashkët.

a) Në lidhje me shkakun për të cilin kërkohet zgjidhja e martesës.

Shkaku për zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, përfaqëson një fakt juridik, i cili ka sjell për pasojë tronditjen e marrëdhënies martesore në atë masë e cila e bën të pamundur vazhdimësinë e jetesës bashkëshortore. Shkaqet e zgjidhjes së martesës me kërkesë të njërit bashkëshort janë parashikuar në nenin 129 dhe në mënyrë orientuese në neni 132 të K.Familjes, duke mos përjashtuar dhe shkaqe të tjera, që rast pas rasti mund të paraqiten në marrëdhëniet bashkëshortore që çojnë në bërjen të pamundur të jetesës së përbashkët.

Në rastin objekt gjykimi, paditësi mban qëndrimin se martesa e ka humbur qëllimin e saj dhe jetesa e përbashkët është bërë e pamundur, pasi mes tyre ka pasur mosmarrëveshje dhe

grindje të vazhdueshme, në lidhje me mënyrën e jetesës dhe mes tyre ka ndarje faktike që prej rreth nëntë vitesh.

Nga shpjegimet e dhëna nga paditësi në kërkesëpadi dhe në seancë pajtimore, gjykata vlerëson se është rasti për të pranuar padinë e paditësit për zgjidhjen e martesës midis bashkëshortëve, pasi gjykata krijoi bindjen se jetesa e përbashkët mes bashkëshortëve është bërë e pamundur dhe martesë ka humbur qëllimin e saj për të dy bashkëshortët, duke cenuar në elementët bazë mbi të cilat mbështet familja, atë të ndjenjës së dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje, sipas nenit 1 të K.Familjes.

Bashkëshortët kanë detyrime ndaj njëri-tjetrit, nga të cilat nuk mund të hiqet dorë, siç janë detyrimi për dashuri dhe respekt reciprok, detyrimi për të ndihmuar njëri tjetrin materialisht dhe moralisht, detyrimi për të rritur dhe edukuar së bashku fëmijët, detyrimi për të respektuar marrëdhëniet e farestinisë të bashkëshortëve, detyrimi për të trajtuar njëri tjetrin me respekt, mirëkuptim dhe dinjitet, detyrimin e bashkëshortëve për të qenë të barabartë, detyrimi i bashkëshortëve për t'i siguruar familjes një jetesë të lirë dhe dinjitoze, detyrimi për të ndihmuar njëri-tjetrin në rast paafësie, sëmundje, detyrimi i bashkëshortit pasjetues për të varrosur bashkëshortin që vdes përpara dhe për të ruajtur të pastër kujtimin e të ndjerit tek fëmijët, të afërmit pasjetues dhe shoqëria.¹

Nga deklaratimet në seancë pajtimore të paditësit, ata e kanë ndërprerë jetesën e përbashkët prej mbi pesë vitesh.

Në zbatim të nenit 133 të K. Familjes, nga bashkëshortët nuk u kërkua që të përcaktohej fajësia për zgjidhjen e martesës dhe në këto kushte kjo rrethanë nuk u mor në shqyrtim nga gjykata.

b) Në lidhje me pamundësinë e jetës së përbashkët dhe humbjen e qëllimit të martesës për bashkëshortët.

Pamundësia e jetës së përbashkët dhe humbja e qëllimit të martesës, shfaqet si pasojë e shkakut për të cilin njëri nga bashkëshortët i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e martesës.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret shkaqet e pretenduara nga paditësjja e kanë sjellë pasojën e pamundësisë së jetës së përbashkët dhe humbjen e qëllimit të martesës dhe duke mos përbërë më bashkësi ligjore të përbashkët që mbështetet në ndjenjën e dashurisë, të respektit dhe mirëkuptimit reciprok, por duke mbetur vetëm një marrëdhënie juridike formale.

c) Lidhja shkakësore ndërmjet shkakut për të cilën kërkohet zgjidhja e martesës dhe pamundësisë së jetës së përbashkët.

Ndërmjet shkakut dhe pamundësisë së jetesës së përbashkët, duhet të vërtetohet ekzistenca e një lidhje shkakësore, pra duhet të vërtetohet se pikërisht ky motiv ka sjellë pamundësinë e vazhdimit të jetës së përbashkët. Gjykata vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, provohet ekzistenca e lidhjes shkakësore midis shkakut "mosmarrëveshjeve në lidhje me mënyrën e jetesës dhe ndërprerjes së jetës së përbashkët për rreth nëntë vjet" dhe "pamundësisë së jetesës së përbashkët", pasojës. Aktualisht palët jetojnë të veçuar nga njëri tjetri, fakt i cili e bën jo vetëm juridikisht, por edhe faktikisht të pamundur jetesën e përbashkët dhe humbjen e qëllimit të martesës.

2.2. Në lidhje me zgjidhjen e pasojave nga zgjidhja e martesës

a) Lënia për rritje dhe edukim e fëmijës njërit bashkëshort.

Marrëdhënia prind-fëmijë është një marrëdhënie e posaçme që, edhe pas zgjidhjes së martesës të prindërve, vazhdon të ekzistojë dhe prindërit vazhdojnë të kenë detyra dhe të drejta për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë.²

Në rastin kur vendoset në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në vendimin që zgjidh martesën, ashtu dhe për mënyrën e takimit të prindit tjetër me fëmijën, në vlerësim të interesit më të lartë të fëmijës, gjykata duhet të marrë parasysh rrethana të tilla si: moshën e fëmijëve, dashurinë e tyre ndaj njërit ose tjetrit prind, gjendjen e tyre psikologjike e sociale, afeksionet e tyre dhe nëse takimet që fëmija do të ketë me prindin tjetër do t'i shërbejnë zhvillimit psiko-motor të fëmijës apo do të mundësojnë ndryshime të tilla që mund të sjellin tek fëmija pasoja negative.³

Në ligj nuk jepet shprehimisht ndonjë rregullim se kujt i lihen fëmijët kur ata kërkohen prej të dy prindërve, por gjykata jep zgjidhjen përfundimtare duke parë rrethanat konkrete, kushtet ekonomike që ofron secili prind për mirërritjen e fëmijës, moshën e fëmijës, qëndrimin e prindërve ndaj fëmijëve dhe më kryesorja interesin më të lartë të fëmijës. Kështu duke pasur parasysh kriteret e mësipërme, si dhe duke parë interesin më të lartë të fëmijëve, gjykata vlerëson se cilit prind do t'i lihen fëmijët, si do të zgjidhen të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve.⁴

Në zbatim të nenit 6 dhe 155 të K.Familjes, gjykata mori mendimin e ekspertit psikolog Elsuida Vila në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës së mitur njërit ishbashkëshort, e cila përgatiti dhe vuri në dispozicion të gjykatës "*Relacion Vlerësimi Psikologjik*", datë 13.01.2022, i cili u administrua si provë në gjykim. Në këtë raport, ekspertja rekomandoi:

"Duke iu referuar faktorëve të mësipërm si:

- *Stilin aktual të jetesës të të dy prindërve*
- *Përceptimin prindëror të të dy prindërve.*
- *Mosprishjen e ekuilibrit që fëmijët kanë aktualisht.*
- *Lidhjen e fortë emocinale që të dy fëmijët kanë me nënën.*
- *Lidhjen e fortë emocionale që fëmijët kanë me njëra-tjetrën.*
- *Kujdesin që ka treguar nëna ndaj fëmijëve në të gjitha aspektet gjatë periudhës së veçimit.*
- *Si dhe në mënyrë të veçantë dëshirën e fëmijve ku relatojnë se ndihen më të qeta dhe të sigurta nën praninë e nënës.*
- *Duke venë në qendër interesin më të lartë të fëmijëve sugjeroj:
Fëmijët: Marina Mehmeti dhe Elina Mehmeti t'i lihen për rritje dhe edukim nënës.*
- *Përsa iu përket takimeve me babain do të sugjeroja me një interval 2 herë në muaj për qëndrim gjatë fundjavës si dhe takimet e tyre me babain gjatë pushimeve verore, dimërore si dhe në raste festash apo ditëlindjesh."*

Gjykata, si për rastin kur vendos në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në vendimin që zgjidh martesën edhe për paditë me të cilat kërkohet të ndryshohet ky vendim, në vlerësim të interesit më të lartë të fëmijës duhet të marrë parasysh rrethana të tilla si: moshën e fëmijëve, dashurinë e tyre ndaj njërit ose tjetrit prind, gjendjen e tyre psikologjike e sociale, afeksionet e tyre, cili nga ata ka kushte ekonomike më të mira për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Kjo e fundit jo gjithmonë mund të shërbejë si shkak determinant.

² Vendim Nr.00-2014-711 (53), datë 20.02.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

³ Po aty.

⁴ Vendim Nr.00-2012-1542 (211), datë 26.04.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

pasí interesat e fëmijës jo në çdo rast janë atje ku janë kushtet materiale më të mira, por atje ku mund të marrë më shumë dashuri dhe një edukim të shëndoshë moral e fizik.⁵

Nga provat e administruara në gjykim dhe deklaratimet e tyre në raportin e vlerësimit psikologjik, rezultoi se paditësja është e punësuar si rrobaqepëse në qytetin e Maliqit, me pagë 30.000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj. Ajo së bashku me fëmijët jeton në banesën e prindërve të saj në qytetin e Maliqit. I padituri, i cili nuk u paraqit në seancë dhe i kontaktuar nga ekspertja ka refuzuar të japë të dhëna në lidhje kushtet e tij morale dhe materiale. Aktualisht ai jeton në shtetin grek.

Gjykata, në drejtim të përcaktimit të aftësisë prindërore të atij prindi që garanton alternativën më të mirë për mirërritjen dhe mirëqenien e fëmijëve, përveç sa më larta, motivohet edhe nga mosha e fëmijëve. Në lidhje me këtë element, gjykata çmon të theksojë se mosha e vogël e fëmijës, nuk mund të përdoret si një kusht *a priori* për të vendosur dhe për të justifikuar lënien për rritje dhe edukim nënës. Ajo merret nga gjykata në konsideratë në përputhje edhe me kriteret e tjera të analizuara në drejtim të aftësisë prindërore të secilit prind. Fëmijë Marina dhe Elena, janë të moshës 10 dhe 9 vjeç dhe ndjekin shkollën në qytetin e Maliqit dhe referuar këtyre rrethanave, faktin që jetojnë dhe banojnë me të ëmën e tyre, paditësen, e cila kujdeset për ta, gjykata vlerëson se kanë nevojë specifike për kujdesin e nënës. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që të mbahet parasysh se fëmijët kanë nevojë emocionale për të qëndruar së bashku, me përjashtim kur ka arsye të forta për të kundërtën. Kjo do të thotë që është e këshillueshme që fëmijët me prindër të njëjtë të mos rriten të ndarë nga njëri-tjetri. Kjo rrezikon që të humbasin edhe prindërit edhe vëllezërit e motrat njëkohësisht. Kjo mund të ketë impakt edhe në raportet e tyre në të ardhmen.⁶

Për këto arsye gjykata vlerëson se interesi më i lartë i fëmijëve është që ata t'i lihen për rritje dhe edukim nënës së saj, paditëses Eriselda Mehmeti, me të cilën jetojnë që nga momenti i veçimit të bashkëshortëve.

Duke marrë parasysh të gjithë elementët e lartpërmendur, gjykata vlerëson se është në interes të fëmijëve, shëndetit dhe stabilitetit të tyre psikologjik, zhvillimit normal dhe të shëndetshëm si dhe rritjes në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi, që rritja dhe edukimi i fëmijëve të mitur Marina dhe Elina Mehmeti, t'i besohen nënës Eriselda Mehmeti.

b) Përcaktimi i mënyrës së ushtrimit të së drejtës së takimit.

Ndarja faktike e prindërve nuk sjell asnjë pasojë në të drejtën e prindit tjetër për të pasur marrëdhënie vetjake me fëmijën. Mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në rastet kur prindërit jetojnë të veçuar, përbën atë që quhet plani i prindërimit, i cili edhe pse nuk parashikohet në mënyrë eksplicite nga K.Familjes, disiplinohet në një sërë elementesh të tij nga dispozitat e këtij kodi.

Kështu në nenin 158 të K.Familjes parashikohet se prindit që nuk i është besuar fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës, e për pasojë të informohet dhe të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme në jetën e tij. Po kështu, në paragrafin e dytë të nenit 158 të K.Familjes parashikohet garantimi i së drejtës së vizitës dhe e banimit në lidhje me prindin të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim.

Në përcaktimin e modaliteteve të takimit si më sipër, gjykata mban parasysh faktin se mënyra e ushtrimit të së drejtës së takimit të fëmijës me prindin, që nuk i është lënë për rritje dhe edukim, duhet të jetë e tillë që ajo të mos sjellë konfuzion dhe paqëndrueshmëri emocionale, psikologjike dhe sociale tek fëmija. Përkundrazi, nga njëra anë të reflektojë të

⁵ Vendim Nr.09-2011-862/2581, datë 17.05.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së I artë
⁶ Vendim Nr.09-2014-711/550, datë 20.02.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së I artë

drejtën e prindit për marrëdhënie vetjake me fëmijën dhe, nga ana tjetër, duke marrë në konsideratë parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të vlejë në kapërcimin më lehtë të ndarjes së prindërve, në qëndrueshmërinë afektive ndaj prindërve dhe të afërmeve të tjerë, në mirëzhvillimin emocional, psikologjik e social të fëmijës.⁷

Në lidhje me mënyrën e ushtrimit të së drejtës së takimit, ekspertja psikologe Elsuicla Vila në raportin e vlerësimit psikologjik datë 13.01.2022, ka rekomanduar: *"Përsa iu përket takimeve me babain do të sugjeroja me një interval 2 herë në muaj për qëndrim gjatë fundjavës si dhe takimet e tyre me babain gjatë pushimeve verore, dimërore si dhe në raste festash apo ditëlindjesh."*

Nisur nga tërësia e fakteve të rezultuara gjatë gjykimit, duke i analizuar ato në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, si dhe duke mbajtur në konsideratë moshën e fëmijës, gjendjen emocionale aktuale që vërehet tek fëmija dhe marrëdhëniet e saj me të dy prindërit, gjykata çmon se vazhdimësia dhe ruajtja e cilësisë të marrëdhënies prind-fëmijë, konkretisht të marrëdhënies ndërmjet të paditurit Zamir Mehmeti dhe fëmijëve Marina dhe Elina Memeti në kushte dhe rrethana të tilla, duhet të realizohet duke patur i padituri duke patur i padituri Zamir Mehmeti të drejtën takimit fundjavën e parë dhe të tretë të çdo muaji, nga dita premtë ora 16:00, deri ditën e dielë ora 16:00, si dhe të kalimit të pushimeve verore nga data 01-10 gusht si dhe ato dimërore nga datë 01-05 janar të çdo viti.

c) Caktimi i detyrimit për ushqim për fëmijët.

Duke marrë parasysh parashikimet e nenit 201 të K.Familjes, në lidhje me caktimin e masës së detyrimit për ushqim mban parasysh nga njëra anë nevojat jetësore të fëmijëve dhe nga ana tjetër mundësitë reale dhe efektive që kanë prindërit për të përmbushur këtë detyrim.⁸

Në çështjen objekt gjykimi, gjykata vlerëson se moshë e fëmijëve të mitur Marina dhe Elina Mehmeti, të cilat janë të moshës 10 dhe 9 vjeç respektivisht, bën që ato të kenë nevojë për disa shpenzime bazë, si të ardhura për mirërritje dhe edukim, për veshje, për ushqim apo për perkujdesje të tjera specifike që janë normale për moshën e tij dhe shpenzime për veçanërisht shkollimin e tyre. Çështja që shtrohet për diskutim është masa e detyrimit për ushqim që duhet të paguajë i padituri ndaj fëmijës, pasi nëna do të jetojë në mënyrë të vazhdueshme me fëmijën, çka e nënkupton përmbushjen e këtij detyrimi.

Paditësja gjatë gjykimit kërkoi që ndaj të paditurit të caktohet një detyrim ushqimor në masën që do të vlerësohet nga gjykata.

Duke pasur parasysh të ardhurat aktuale të së dy bashkëshortëve, faktin që paditësja është aktualisht e punësuar si rrobaqepëse me 30.000 (tridhjetë mijë) lekë pagë, e mbështetet në nevojat për banim e jetesë edhe nga familja e origjinës dhe i padituri jeton në Greqi, moshën e tyre dhe mundësitë reale të palëve për gjenerimin e të ardhurave, nevojat për rritje dhe edukim të shëndetshëm të fëmijës dhe për të mos vuajtur nga ana ekonomike pasojat e zgjidhjes së martesës, apo për të mos ulur standardin e jetesës pas zgjidhjes së martesës, gjykata çmon që masa e detyrimit ushqimor që duhet të paguajë i padituri Zamir Mehmeti, kundrejt fëmijëve të mitur Marina dhe Elina Mehmeti, është në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për secilin fëmijë.

⁷ Po aty.

⁸ Vendim Nr.06-261 –2288 (436), datë 03.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë: *"Në kushtet kur legjislativi ynë familjar nuk e parashikon masën e këtij kontributi, si për sa i përket përcaktimit të një kufiri minimal, ashtu dhe atij maksimal, ky Kolegj vlerëson se gjykata e faktit, referuar kriterëve ligjorë të parashikuara në nenin 158 dhe 201 të Kodit të Familjes, me të drejtë në përcaktimin e këtij kontributi kanë marrë në konsideratë raportin e burimeve të të ardhurave të paditësit me ato të paditurës dhe këto të ardhura në raport me nevojat e fëmijës dhe mundësinë ekonomike të paditësit. Pra gjykata kanë caktuar masën e detyrimit ushqimor të paditësit ndaj fëmijës A. V., nisur nga raportin midis: (1) Nevojave të fëmijës dhe (2) mundësive ekonomike të paditësit G. V., mbi të cilin bie ky detyrim dhe ato të paditurës, së cilës i është lënë fëmija për rritje dhe edukim."*

Gjykata vë në dukje faktin se vendimi për caktimin e detyrimit për ushqim, është një vendim i cili, sikurse edhe ai i përcaktimit të mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, nuk merr formë të prerë në kuptimin substancial të tij, për faktin se ai është i ndryshueshëm mbi kërkesën e palëve, në rastin e parë kur pala arrin të vërtetojë se kanë ndryshuar kushtet dhe rrethanat mbi bazën e të cilave është marrë ky vendim.

d) Për sa i përket mbiemrit.

Me lidhjen e martesës, bashkëshortët mbajnë mbiemrin e tyre ose marrin një mbiemër të përbashkët që mund të jetë ai i burrit ose gruas. Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës.

Në rastin konkret, siç rezulton nga certifikatën e martesës datë lëshimi 24.05.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë, Bashkia Korçë, paditësja ka ndryshuar mbiemrin pas lidhjes së martesës, nga "Metani", duke marrë atë të të paditurit "Mehmeti".

Paditësja në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit kërkoi të rimarrë mbiemrin para martese.

Nga sa më sipër, me zgjidhjen e martesës, paditësja Eriselda Mehmeti rimerr mbiemrin që ka pasur para martesës "Metani".

Në zbatim të nenit 143 të K.Familjes, një kopje e vendimit, pasi ai të ketë marrë formë të prerë, dërgohet nga gjykata për regjistrim në Zyrën e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë, Bashkia Korçë.

Shpenzimet gjyqësore në raportet ½ pjesë për secilën palë, të cilat janë parapaguar nga paditësja.

Për sa më lart, gjykata vlerëson se padia e paraqitur nga paditësja është e bazuar dhe si e tillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 129, 132, 143, 146, 154, 156 dhe 161 të Kodit të Familjes, si dhe nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI:

1. Pranimin e padisë me paditëse Eriselda Mehmeti dhe të paditur Zamir Mehmeti.
2. Zgjidhjen e martesës midis bashkëshortëve Eriselda Mehmeti dhe Zamir Mehmeti e lidhur më datë 20.09.2010.
3. Me zgjidhjen e martesës paditësja Eriselda Mehmeti merr mbiemrin e para martese, atë "Metani".
4. Lënien për rritje dhe edukim të fëmijës Marina Mehmeti dhe Elina Mehmeti, nënës së tyre Eriselda Mehmeti, duke patur i padituri Zamir Mehmeti të drejtën takimit fundjavën e parë dhe të tretë të çdo muaji, nga dita premtë ora 16:00, deri ditën e dielë ora 16:00, si dhe të kalimit të pushimeve verore nga data 01-10 gusht si dhe ato dimërore nga datë 01-05 janar të çdo viti.
5. Detyrimin e të paditurit Zamir Mehmeti të paguajë detyrim ushqimor në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, për secilin fëmijë të mitur Marina Mehmeti dhe Elina Mehmeti.
6. Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për këtë vendim gjyqësor i cili përbën titull ekzekutiv me marrjen e vendimit formë të prerë dhe ekzekutohet nga përmbaruesi gjyqësor.

7. Urdhërohet Kryesekretaria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që brenda 15 ditëve nga dita që ky vendim merr formë të prerë të dërgojë një kopje të tij në Zyrën e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë. Bashkia Korçë për pasqyrimin e tij në regjistrat përkatës.

8. Shpenzimet gjyqësore në raportet ½ pjesë për secilën palë.

9. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 ditëve nga

e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, sot më datë 13.01.2022.

SEKRETARE
ZAMIRA SHKËMBI

GJYQTAR
ERYIN SULAJ

Shpenzime gjyqësore

Tarifë mbi aktet	3,000 lekë
<u>Shpenzime eksperti psikolog</u>	<u>30,000 lekë</u>
Totali	33,000 lekë